

PLANI I MENAXHIMIT PËR KALANË E PRIZRENIT

PLANI I MENAXHIMIT

PËR KALANË E PRIZRENIT



2020-2025



Hartuar nga:



Trashëgimia Kulturore pa Kufij Kosovë/ Cultural Heritage without Borders

në bashkëpunime me:

Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

dhe institucionet publike vartëse të Trashëgimisë Kulturore



REPUBLIKA E KOSOVËS

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

PLANI I MENAXHIMIT PËR KALANË E PRIZRENIT



REPUBLIKA E KOSOVËS
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Tabela e Përmbajtjes

PLANI I MENAXHIMIT	1
PËR KALANË E PRIZRENIT	1
PLANI I MENAXHIMIT PËR KALANË E PRIZRENIT	3
PARATHËNIE	6
Sali Shoshi, Drejtor i Trashëgimisë Kulturore pa Kufij (CHwB), Kosovë	6
SHKURTESAT	7
PËRMBLEDHJE	8
1. DEKLARATA E RËNDËSISË E KALASË SË PRIZRENIT	9
2. GJENDJA E PËRGJITHSHME E LOKALITETIT	9
3. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME DHE VIZIONI	12
<i>Kalaja Prizrenit, kurorë e qytetërimeve, pikëtakim i brezave që rrezaton lashtësi, identitet dhe ardhmëri.</i>	13
4. FUSHAT E VEPRIMIT ME OBJEKTIVAT GJENERALE	13
4.1. Fushat e veprimit	14
4.1.1. Konservimi dhe Adaptimi	14
4.1.2. Edukimi dhe Hulumtimi	16
4.1.3. Zhvillimi Ekonomik dhe i Turizmit	17
4.1.4. Komunikimi: Prezantimi, Interpretimi dhe Promovimi	18
4.1.5. Korniza Institucionale dhe Ligjore	19
4.1.6. Infrastruktura	20
4.1.7. Mjedisi	20
4.1.9. Planifikimi Hapësinor	20
5. HISTORIA DHE PËRSHKRIMI	21
5.1. Përshkrim i shkurtër i lokalitetit	21
5.2. Mbrojtja ligjore	21
5.3. Historia	21
5.4. Dokumentacioni i gjendjes ekzistuese	22
5.5. Fotografi	22
5.6. Publikime	22
5.7. Materialet arkivore	23

PLANI I MENAXHIMIT PËR KALANË E PRIZRENIT

5.8.	Rezultatet e hulumtimeve paraprake	23
5.9.	Dëmtimet	24
5.10.	Punët e mëparshme konservuese apo restauruese	24
6.	PALËT E INTERESIT	26
6.1.	Identifikimi i palëve të interesit dhe roli i tyre	26
6.2.	Grupimi i palëve të interesit në tri grupe sipas ndikimit të tyre në plan	27
6.2.1.	Palët e interesit që drejtpërdrejt ndikojnë në Plan	27
6.2.2.	Neutral, por të interesuar për planin.....	27
6.2.3.	Palët e interesit jo relevant apo pa ndikim në Plan	27
7.	PLANI I VEPRIMIT (Tabela e detajuar e bashkëngjitur ne aneks 1)	28
8.	NJËSIA MENAXHUESE.....	30
8.1.	Organizimi dhe përgjegjësitë.....	31
8.2.	Buxheti	31
	REFERENCAT	33
	FOTOGRAFITË	33

PARATHËNIE

Sali Shoshi, Drejtor i Trashëgimisë Kulturore pa Kufij (CHwB), Kosovë

Kosova ishte epiqendër e zhvillimeve historike duke lënë të gjurmë kulturore në format e tyre fizikë dhe shpirtërore. Këto ndërthurje vlerash mbasin një testament për ta përcjellur të gjeneratat tjera. Prandaj ato mbasin një sfida që kërkojnë angazhimin tonë të përbashkët.

Vendi ynë ka nevojë për avancim të politikave në menaxhimin efektiv të trashëgimisë kulturore duke hapur mundësitë për përfshirjen e mbrojtës se trashëgimisë në politikat e zhvillimit, duke e vendosur mjedisin historik në zemër të planifikimit dhe zhvillimit, si dhe për të rritur rolin e komuniteteve që jetojnë dhe veprojnë në këto vende.

Plani i Menaxhimit për Kalanë e Prizrenit paraqet një dokument përmbledhës qy synon identifikimin dhe venien në funksion të resurseve kulturore, natyrore dhe njerëzore në të mirë të ruajtës dhe rikthimin në shoqëri të Kalasë si një vlerë e re e rëndësishme. Plani i Menaxhimit është përmbledhje e projeksioneve të nxjerrura nga nga një seri e diskutimëve në mes të hisedarëve që përfaqësonin sektorin publik dhe shoqërinë civile. Qëllimi hartuesëve ishte që dokumenti të nxjerr me të mirën në kontekstin aktual.

Hapi i tjetër përpara është zbatimit i këtij Plani. Institucionet publike duhet të alokojnë mjetet e nevojshme financiare dhe duhet të garantojnë një proces transparent në përfshirjen resurseve njerëzore të nevojshme. Kjo është mënyra e vetme për ta përmbledhur Kalanë e Prizrenit si një tregim të suksesshëm dhe inspirues.

SHKURTESAT

CHwB	Cultural Heritage without Borders DSHP
DUPH	Drejtoria e Shërbimeve Publike Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor
GPI	Grupi i Palëve të Interesit
IAK	Instituti Arkeologjik i Kosovës
KP	Kalaja e Prizrenit
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
NM	Njësia Menaxhuese
OJQ	Organizatë Jo qeveritare
QRTK	Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore
TK	Trashëgimia Kulturore

PËRMBLEDHJE

Plani i menaxhimit për Kalanë e Prizrenit është pjesë e projektit 'Ruajtja e Kalasë së Prizrenit', financuar nga Ambasada e SHBA-së dhe implementuar nga organizata Trashëgimia Kulturore pa Kufj (CHwB Kosova).

Ky plan i menaxhimit përshkruan rëndësinë dhe historinë e Kalasë së Prizrenit, si dhe veprimet e nevojshme për menaxhimin e qëndrueshëm dhe të duhur të saj. Përmes një qasje strategjike, duke siguruar pjesëmarrjen në proces të aktorëve kyç sikurse janë institucionet përgjegjëse për mbrojtje, menaxhim e edukim, shoqëria civile, përfaqësues të komunitetit e ekspert të profileve të ndryshme, procesi është zhvilluar në disa etapa. Përmes takimeve dhe punëtorive me palët e interesit, në punëtorinë e parë është konstatuar gjendja ekzistuese. Është formuluar vizioni dhe janë vendosur objektivat. Në punëtoritë e radhës, të ndarë në grupe, pjesëmarrësit përmes analizës SWOT kanë identifikuar çështjet kritike të cilat konsiderohen të rëndësishme që të adresohen përmes planit të menaxhimit. Këto çështje kritike më pas janë analizuar dhe sistemuar nëpër fusha të ndryshme të veprimit. Për secilën nga fushat e veprimit është bërë analizë e hollësishme SWOT me fokus të veçantë në dobësitë dhe mundësitë. Më pas është bërë përcaktimi i objektivave, definimi i aktiviteteve duke identifikuar palët përgjegjëse, afatet, koston e përafërt dhe burimet e financimit.

Plani gjithashtu përcakton një kornizë për bashkëpunim në mes të të gjitha institucioneve, grupeve dhe individëve që marrin pjesë në menaxhimin e lokalitetit. Draft Plan i Menaxhimit është hartuar në bashkëpunim me palët e interesit dhe diskutimeve me ekspertë, për të përcaktuar Organogramin e Menaxhimit, Rregullorën e Brendshme dhe marrëveshjet midis palëve të interesit. Plan i përmban objektivat kryesore dhe planin e veprimit për pesë vitet e ardhshme, kur plani do të rishikohet dhe përditësohet.

1. DEKLARATA E RËNDËSISË E KALASË SË PRIZRENIT

Kalaja e Prizrenit është një nga monumentet më të veçanta të trashëgimisë kulturore të Republikës së Kosovës. E vendosur në një koder në formë shale, mbi qytetin e Prizrenit, ajo kontrollon gjithë prapatoken e zonës dhe ka kontrolluar gjatë gjithë periudhave prehistorike dhe historike, rrugën që e lidhte adriatikut me ballkanin qendror, në njëren anë dhe në anën tjetër rrugën e kanionit të lumbardhit të Prizrenit në drejtim të pellgut të Shkupit.

Pozita shumë e vecant gjeostrategjike dhe gjeografike e kalasë, në fund të skajit më jugor të Rrafshit të Dukagjinit, paraqet gjurmën më të hershme të qytetit të Prizrenit.

Gërmimet arkeologjike të deritanishme kane treguar se kalaja ka filluar të banohej që në periudhën e eneolitit- bakrit (3500-2500 para Kr.), për të vazhduar edhe gjatë periudhave iliro-dardane të bronzit dhe hekurit. Intenziteti më i madh i banimit shihet qartë me ndërtimin e mureve masive rrethuese të ndërtuara në periudhën e vonë romake dhe perandori bizantin me prejardhje dardane Justiniani I (527-565 pas Kr.) rindërtoi kalanë e “Petrizen” gjate sundimit të tij. Jeta në kala pothuajse pandërprer ka vazhduar deri në vitin 1913 kur gjatë luftërave ballkanike kur u dëmtua rëndë dhe u braktis kalaja.

Pas aktivitetetve shkencore dhe restauruse disa vjecare të MKRS- IAK, ajo është shëndrruar në top atraksion të turizmit kulturor.

Cdo vizitor mahnitet me pejsazhin përrethe kalasë, pasurinë arkeologjike dhe arkitekturore si dhe me kulturën e pasur që tanimë është e prezantuar edhe në muzeun e kalasë, e bëne kalanë në cdo aspekt top atraksion të turizmit, arkivi më i vecant për studimin e kulturave prehistorike, antiko-mesjtare e deri në ditët tona.

Ajo është shëndrruar në pasaport të vecant të identitetit kulturor e kombëtar të Republikës së Kosovës.

2. GJENDJA E PËRGJITHSHME E LOKALITETIT

Për ruajtjen dhe mbrojtjen e Kalasë së Prizrenit si lokalitet arkeologjik i trashëgimisë kulturore, faktorët politik luajnë rol kyç në formësimin aktivitetëve dhe prioriteteve të procesit. Prioritetet e përcaktuara janë horminizuar me objektivat e institucioneve lokale dhe atyre qendrore. Në përgjithësi, degradimi i qendrës historike të Prizrenit, moszbatimi i ligjit apo politikat e orjentuara në menyre jo adekuate kanë ndikim shumë të madh në zhvillimin ekonomik, social, mjedisor, teknologjik dhe legjislativ.

Të gjitha vendet, si ato të zhvilluara apo që janë në zhvillim e sipër, investojnë në ruajtjen e qendrave të tyre të vjetra me projekte të ndryshme me theks të veçantë në monumentet e trashëgimisë kulturore për të krijuar mundësitë e rritjes së të ardhurave dhe rritjes ekonomike. Rritja e ndërgjegjësimit publik për mos degradimin e qendrës historike, evitimi i rasteve të ndryshme të vandalizmit, kufizimi i qasjes me mjete motorike në zonën e mbrojtur apo tendencave të ndryshme për rindërtime do ta ulë rrezikshmërinë edhe për dëmtimin e Kalasë.

Politika – përkujdesja ndaj trashëgimisë kulturore është përgjegjësi e të gjithëve. Rol të rëndësishëm në këtë aspekt luan faktori politik që duhet të përkujdeset për krijimin e strategjive për ruajtjen dhe menaxhimin e saj. Në rastin e Kalasë së Prizrenit janë evidentuar faktorët politik të cilët paraqesin shkallë të caktuar të rrezikut duke filluar nga shkalla e ulët, mesme dhe e lartë.

Menaxhimi jo i duhur i kalasë dhe po ashtu administrimi në nivel jo të duhur vlerësohen si faktorë që

paraqesin rrezik në shkallë të ulët. Në këtë masë politika ka ndikim edhe në degradimin, humbjen e kalasë për brezat pasardhës. Edhe pse në shkallë të ulët faktori politik përfshihet dhe paraqet rrezik edhe në intervenimet/ adaptimet joadekuate në kala, degradimet që nuk referohen në materialet autentike. Menaxhimi i kontrolluar nga institucionet publike pa pjesëmarrje të komunitetit vlerësohet si rrezik i vazhdueshëm.

Këto lidhen edhe me mungesën e vullnetit politik nga ana e autoriteteve lokale për mbarrëvajtjen e procesit të ruajtjes dhe menaxhimit të kalasë dhe me mbikëqyrjen jo të duhur institucionale të cilat vlerësohen si rreziqe të shkallës së mesme. Në të njëjtën kategori hyjnë edhe mos koordinimi mes nivelit qendror dhe atij lokal si dhe mos koordinimi mes palëve që çon në marrjen e vendimeve të gabuara. Interesimi i ulët i komunës për të përcjellë zhvillimet që po ndodhin dhe politikat e orientuarane menyre jo adekuate janë në të njëjtin nivel. Mos aprovimi i planit menaxhues me të gjithë komponentët është i dëmshëm për kalanë.

Faktorë tjerë politik që paraqesin shkallë të lartë të rrezikut janë idetë e shumta para fushatave elektorale që rezultojnë me ndryshimin e prioriteteve nga ana e institucioneve. Vazhdimi i degradimit të qendrës historike të Prizrenit, moszbatimi i ligjit po e dëmtojnë procesin e ruajtjes së kalasë.

Ekonomia – Dihet që ekonomia luan një rol të madh në jetën tonë të përditshme dhe rol edhe më të madh në sferën e kulturës dhe artit. Ndikimi i kushteve ekonomike paraqet sfidë në të menduarit për ruajtjen e trashëgimisë. Ne përballemi me vështirësi dhe pengesa dhe vazhdimisht e shohim që ndikimi i kushteve ekonomike në vlerat kulturore, sociale, politike, dhe estetike është në rritje. Edhe në rastin e Kalasë së Prizrenit evidentohen shumë faktorë nga aspekti ekonomik që kanë ndikim në procesin e ruajtjes.

Mbingarkesa dhe zhvillimet e ndryshme që po ndodhin në kala vlerësohen si rrezik i shkallës së ulët. Gjatë punimeve në kala për shkak të pasigurisë janë paditë civile që paraqesin rrezik për zhvillimet e mëtutjeshme. Mos referimi në materiale autentike shkakton degradimin e kalasë që është vlerësuar si rrezik i shkallës së njëjtë. Intervenimet/ adaptimet jo adekuate që nuk bazohen në kriteret e kërkuara janë të dëmshme për kalanë. Në këtë kategori bën pjesë edhe degradimi, humbja e kalasë për brezat e ardhshëm.

Kategoria tjetër e faktorëve të cilët vlerësohen të rrezikshmërisë së mesme për kalanë përfshijnë një numër të konsiderueshëm të tyre. Mos aprovimi i Planit të Menaxhimit me të gjithë komponentët nga ana e institucioneve është faktor që e dëmton procesin. Politikat e orientuara në menyre jo adekuate ose për interesa personale evidentohen edhe në rastin e kalasë e që vlerësohen si rrezik i mesëm për zhvillimet e mëtutjeshme. Komercializimi/ aktivitetet biznesore që po ndodhin në hapësirën e mbrojtur të kalasë janë të dëmshme. Mos mirëmbajtja e pjesëve të ndryshme pas adaptimit është problem që mund të çojë në dëmtimin e madje edhe humbjen e atyre pjesëve. Mosfunksionimi i duhur i muzeut është pengesë e madhe, humbje e mundësisë për informimin e turistëve për një pjesë shumë të rëndësishme për qytetin. Dhënia e hapësirës jo adekuate për zhvillimin e bizneseve të ndryshme dhe rritja e pakontrolluar e bizneseve dhe zhvillimeve afër perimetrit të kalasë e cenon kalanë dhe vlerat e saj.

Kategoria e faktorëve të cilët paraqesin rrezik të lartë për kalanë fillon me degradimin e vazhdueshëm të qendrës historike të qytetit, për të vazhduar me mos zbatimin e ligjit i cili mbron monumentet dhe zonat përreth. Ndryshime i prioriteteve nga ana e autoriteteve lokale e dëmton procesin e ruajtjes së kalasë në shkallë të lartë. Prania e basenit të ujit paraqet shkallë të lartë të rrezikut për kalanë edhe në aspektin ekonomik.

Shoqëria – faktorët social kontribuojnë në trashëgiminë kulturore duke rritur dhe ruajtur vlerat e saj. Ajo që tash konsiderohet trashëgimi kulturore është krijuar nga kreativiteti i njerëzve. Mënyra se si perceptohen këto vlera lidhet me nivelin e vetëdijes së shoqërisë. Përpos ndikimeve pozitive që

faktori social mund të ketë, janë edhe ndikimet negative që mund të çojnë në përkeqësimin e gjendjes së monumenteve apo lokaliteteve.

Mbingarkesa dhe zhvillimet që po ndodhin në kala konsiderohen faktorë me rrezikshmëri të ulët për kalanë. Në këtë kategori bën pjesë edhe degradimi i kalasë nga mos referimi në materialet autentike. Intervenimet/ adaptimet jo adekuate, degradimi, humbja e kalasë për brezat pasardhës vlerësohen të dëmshme për procesin. Humbja e identitetit/ autenticitetit, bllokimi i shkencës, mbyllja e Grupit Punues në vete konsiderohet faktor me rrezikshmëri të ulët. Menaxhimi joadekuat i mbeturinave gjithashtu e cenon kalanë. Vetëdijesimi i komunitetit është faktor i rëndësishëm për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e kalasë.

Në kategorinë e faktorëve social me rrezikshmëri të shkallës së mesme hyjnë një numër i konsiderueshëm i faktorëve. Rreziku i shkatërrimit nga faktorët natyror vlerësohet si rrezik i shkallës së mesme. Tendencat për rindërtim- sidomos të xhamisë nga ana e komunitetit në fazën kur nuk është e paraparë sipas planit konsiderohen të dëmshme për kalanë. Shenjat e vandalizmit prezentë në kala dëmtojnë imazhin dhe vlerësohen të rrezikshme. Në rast mos aprovimi të Planit të Menaxhimit me të gjitha komponentët nga ana e institucioneve vlerësohet të jetë rrezik i shkallës së mesme për kalanë. Politikat e orientuara në mënyrë jo adekuate nga ana e autoriteteve lokale janë të dëmshme për procesin. Mosmirëmbajtja pas adaptimit është pikë shumë e rëndësishme sepse mund të dërgojë në dëmtime të sërishe. Mosfunksionimi i duhur i muzeut është pengesë e madhe, humbje e mundësisë për edukimin dhe vetëdijesimin e shoqërisë në aspektin e ruajtjes së vlerave. Mungesa e politikave zhvillimore në nivel lokal dhe nacional konsiderohet rrezik i shkallës së mesme për kalanë. Rritja e pakontrolluar e bizneseve dhe zhvillimeve afër perimetrit të kalasë dhe qasja me mjete motorike kanë ndikim direkt në procesin e ruajtjes.

Në kategorinë e faktorëve social të rrezikut të lartë për kalanë bëjnë pjesë: degradimi i qendrës historiketë Prizrenit, moszbatimi i ligjit nga ana e institucioneve nga njëra anë dhe shoqërisë nga ana tjetër, ndryshimi i prioritetëve të autoriteteve lokale në raport me proceset që po ndodhin në kala.

Teknologjia- fatmirësisht me zhvillimin e teknologjisë, sot metodat dhe metodologjitë e ruajtjes së vlerave të trashëgimisë kulturore dukshëm janë përmirësuar. Falë saj sot kemi shumë fotografi, dokumente, analiza lehtë të qasshme për të gjithë. Por zhvillimi i teknologjisë mund të ketë edhe ndikime negative në trashëgimi. Në rastin e kalasë së Prizrenit, faktorë në të cilët ndikon teknologjia dhe që vlerësohen me rrezikshmëri të ulët janë: degradimi i kalasë nëse nuk referohemi në materialet autentike, intervenimet/ adaptimet jo adekuate, degradimi humbja e kalasë për brezat e ardhshëm. Mos aprovimi i Planit të Menaxhimit me të gjitha komponentët nga ana e institucioneve dhe politikat e orientuara në mënyrë jo adekuate hyjnë në kategorinë e rrezikshmërisë së mesme. Mos mirëmbajtja pas adaptimit rrezikon funksionimin e muzeut të posa themeluar. Rritja e pakontrolluar e bizneseve dhe zhvillimeve afër perimetrit të kalasë në aspektin teknologjik e dëmton kalanë, po ashtu edhe qasja me mjete motorike.

Në kategorinë e faktorëve që ka ndikim teknologjia me shkallë të rrezikut të lartë konsiderohen; degradimi i qendrës historike të Prizrenit, mos zbatimi i ligjit dhe prania e basenit të ujit në hapësirën e kalasë.

Mjedisi – faktorët natyror si moti, klima, kushtet meteorologjike (temperatura, lagështia e ajrit, erërat, të reshurat) kanë ndikim të madh në ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Mbrojtja e mjedisit është pikë shumë e rëndësishme gjatë zhvillimit të ndërtimeve sot. Në grupin e faktorëve që kanë

ndikim në mjedis dhe që konsiderohen me rrezik të shkallës së ulët janë: mbingarkesa dhe zhvillimet në kala që mund të cenojnë rrethinën, degradimi i kalasë nëse nuk referohemi në materiale autentike por përdoren materiale tjera që janë të dëmshme për ambientin. Intervenimet/ adaptimet joadekuate mund të dëmtojnë edhe mjedisin nëse nuk janë në përputhje me standardet mjedisore. Degradimi, humbja e kalasë për brezat pasardhës vlerësohet si faktor i rrezikshmërisë së ulët. Menaxhimi joadekuat i mbeturinave dhe mos vetëdijesimi i komunitetit për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e rrethinës kanë pasoja mjedisore.

Në kategorinë e faktorëve që kanë ndikim në aspektin mjedisor me shkallë të mesme të rrezikut bën pjesë rreziku i shkatërrimit nga faktorët natyror (të reshurat, erërat, rrëshqitjet e dheut, temperaturat ekstreme, tërmetet). Po ashtu mos aprovimi i Planit të Menaxhimit me të gjitha komponentët nga ana e institucioneve dhe politikat e orientuara në mënyrë jo adekuate hyjnë në këtë kategori. Mos mirëmbajtja pas adaptimit, rritja e pakontrolluar e bizneseve dhe zhvillimeve afër perimetrit të kalasë, qasja me mjete motorike janë faktorë që konsiderohen me ndikim dhe rrezikshmëri të shkallës së mesme për kalanë dhe mjedisin përreth. Me shkallë të rrezikshmërisë së lartë për kalanë dhe mjedisin përreth konsiderohen: degradimi i qendrës historike të Prizrenit, mos zbatimi i ligjit për trashëgimi, prania e basenit të ujit në territorin e kalasë.

Legjislacioni – aspekti legjislativ ka ndikim të madh në mënyrën e menaxhimit dhe funksionimit të trashëgimisë kulturore. Në grupin e faktorëve që kanë ndikim në aspektin legjislativ me shkallë të ulët të rrezikut vlerësohen: menaxhimi jo i duhur i kalasë, administrimi jo i duhur nga ana e organeve kompetente. Paditë civile ndaj pasigurisë apo degradimi i kalasë nëse nuk referohemi në materialet autentike konsiderohen si faktorë me rrezik të shkallës së ulët. Intervenimet/ adaptimet jo adekuate konsiderohen të dëmshme. Degradimi, humbja e kalasë për brezat pasardhës edhe pse me shkallë të ulët të rrezikut duhet konsideruar. Humbja e identitetit/ autenticiteti dhe shuarja e GPI në vete hyn në këtë kategori. Menaxhimi jo adekuat i mbeturinave po ashtu dëmton trashëgiminë.

Në kategorinë e faktorëve me shkallë të mesme të rrezikut për kalanë hyn mbikëqyrja institucionale jo e duhur, mos koordinimi mes palëve pjesëmarrëse në proces, mos koordinimi në mes të nivelit qendror dhe atij lokal. Mos aprovimi i planit të menaxhimit më të gjithë komponentët, politikat e orientuara në mënyrë jo adekuate vlerësohen në këtë kategori. Mos mirëmbajtja pas adaptimit, rritja e pakontrolluar e bizneseve dhe zhvillimeve afër perimetrit të kalasë vlerësohen me shkallë të mesme të rrezikut. Si faktorë me shkallë të lartë të rrezikut edhe në aspektin legjislativ paraqitet degradimi i qendrës historike të Prizrenit, mos zbatimi i ligjit për mbrojtjen e trashëgimisë.

3. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME DHE VIZIONI

1. Krijimi i një ambienti të ri për kënaqësi kulturore dhe natyrore
2. Krijimi i të kuptuarit më të mirë të Kalasë së rehabilituar
3. Paraqitja e një koncepti të ri të integruar të vlerave të trashëgimisë dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm për përfitime sociale, ekonomike dhe kulturore.

Vizioni për Kalanë e Prizrenit:

Kalaja Prizrenit, kurorë e qytetërimeve, pikëtakim i brezave që rrezaton lashtësi, identitet dhe ardhmëri.

4. FUSHAT E VEPRIMIT ME OBJEKTIVAT GJENERALE

Prej 9 fushave të veprimit, si më poshtë:

- **Konservimi dhe adaptimi**
- **Korniza institucionale dhe ligjore**
- **Edukimi dhe hulumtimi**
- **Zhvillimi ekonomik dhe i turizmit**
- **Komunikim: Interpretim, Prezantim dhe Promovim**
- **Mjedisi**
- **Planifikimi Hapësinor**
- **Infrastruktura**
- **Menaxhimi i Riskut**

Fillimisht është bërë fuzionimi i 4 fushave të fundit në një të vetme - Mjedisi, Planifikimi Hapësinor, Infrastruktura dhe Menaxhimi i Riskut, e më pas janë caktuar Objektivat për zhvillimin e Kalasë së Prizrenit duke u bazuar në fushat e veprimit, sikurse më poshtë. Pas caktimit të objektivave, janë listuar aktivitetet të shkrira në afat kohor për përmbushjen e tyre, koston, burimin e financimit dhe institucionin përgjegjës për realizimin e tyre. (Shih tabelën 1- Plani i veprimit për Kalanë e Prizrenit)

FUSHAT E VEPRIMIT	OBJEKTIVAT
1. Konservimi dhe adaptimi	1.1 Të përcaktohet plani i konservimit për pjesët e pa trajtuara të kalasë (pas gërmimeve arkeologjike me karakter pastrimi), duke pasur parasysh zonat e hulumtuara dhe të pa hulumtuara që paraqesin potencial për gjeneratat e profesionistëve të ardhshëm. 1.2 Të bëhet adaptimi i kalasë, si mundësi për rritjen e atraktivitetit të lokalitetit, vënien e funksioneve adekuate në shërbim të turizmit kulturor dhe të ofrimit të mundësive për zhvillimin e artizanaleve, në shërbim të ruajtjes së traditës. 1.3 Të përmirësohet komunikimi ndër-institucional përmes rritjes së transparencës, monitorimeve dhe raportimeve periodike.

PLANI I MENAXHIMIT PËR KALANË E PRIZRENIT

2. Korniza institucionale dhe ligjore	2.1 Të definohet zona për konservim në kala. 2.2 Të bëhet menaxhimi efektiv i lokalitetit. 2.3 Të hartohen standardet dhe udhëzuesit për njësinë menaxhuese.
3. Edukimi dhe hulumtimi	3.1 Të rritet numri i aktiviteteve lidhur me prezantimin e kalasë 3.2 Të rritet numri i hulumtimeve dhe botimeve shkencore. 3.3 Të rriten investimet e jashtme në fushën e edukimit dhe hulumtimit.
4. Zhvillimi ekonomik dhe i turizmit	4.1 Të trajtohet qasja fizike në kala. 4.2 Të gjenerohen të ardhura, në mënyrë që kalaja të jetë e vetë-qëndrueshme.
5. Komunikim: Interpretim, Prezantim dhe Promovim	5.1 Kalaja e Prizrenit, të jetë e qasshme për të gjithë. 5.2 Të hartohen udhëzues dhe bazë ligjore për interpretim. 5.3 Kalaja të funksionojë si hapësirë multifunksionale.
6. Mjedis, Planifikimi Hapësinor, Infrastruktura dhe Menaxhimi i Riskut	6.1 Të trajtohen/ ndërtohen rrugët për në kala. 6.2 Të ketë siguri të shtuar për monumentin dhe vizitorët. 6.3 Të harmonizohen dokumentet/ planet lidhur me kalanë.

4.1. Fushat e veprimit

4.1.1. Konservimi dhe Adaptimi

Në kala të Prizrenit po zhvillohen aktivitete konservuese nga Instituti Arkeologjik i Kosovës që janë në proces e sipër. Për shkak të punëve në zhvillim, qasja e vizitorëve është e vështërsuar, dhe lëvizja e tyre është e rrezikuar. I rrezikut të lartë konsiderohet edhe prania e basenit të ujit në territorin e kalasë. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ne vazhdimesi qe nga viti 2012-2019 ka financuar punet konservuese të strukturave të Kalasë, projekt ky që implementohet nga IAK. Ministria gjithashtu ka financuar edhe projektin e Muzeut ne Kala i cili u hap me 1 gusht 2019. Projektet tjetër qe eshte zhvilluar është edhe 'Ruajtja dhe Mbrojtja e Kalasë së Prizrenit', financuar nga Ambasada Amerikane 2015- 2017 për Planin e Adaptimit, Menaxhimit dhe Interpretimit, implementuar nga CHwB. Sidoqoftë, punët konservuese që po zbatohen nga IAK nuk rezultojnë me raporte për palët e interesit. Në të njëjtën kohë, ka tejkalime të planit të hartuar nga PM Group- plan në të cilin bazohet IAK. Sa i përket planeve të tjera, në arkivin e QRTK Prizren ka projekte, hulumtime dhe të dhëna mbi lokalitetin e Kalasë. Lokaliteti në fjalë ka përkrahje financiare nga MKRS deri në 2019, si dhe nga Ambasada e Amerikës deri në 2017. Megjithatë, ky buxhet nuk është i mjaftueshëm për kompletimin e adaptimit të tërësishëm të lokalitetit. Sidoqoftë, prezenca e këtyre dy donatorëve mund të tërheq donatorë tjerë në të ardhmen, në mënyrë që trajtimi i kalasë të jetë i kompletuar. Kalaja e Prizrenit, si

lokalitet shumë shtresor, ofron mundësi të shfrytëzimit të tij për përfitime kulturore, ekonomike, mjedisore, shkencore dhe ngritjen e kapaciteteve lokale.

Përparësitë

- Autenticiteti- shumë shtresa kulturore
- Aktivitetet në proces
- Rezultatet e reja arkeologjike
- Plani i konservimit/ revitalizimit
- Vazhdimi i investimeve
- Adaptimi i disa strukturave për përdorim
- Plani për rehabilitimin e rrugëve deri në kala (ndriçimi, ulëse, vrojtues)
- Lokalitet edukativ (in situ)

Dobësitë

- Mungesa e raporteve të zbatimit të punimeve
- Mos zbatimi (tejkalimit i planit të konservimit/ revitalizimit)
- Mungesa e laboratorëve (standarde e konservimit)
- Buxheti i pamjaftueshëm
- Mungesa e eksperteve (për periudha të mesjetës)
- Mungesa e infrastrukturës
- Rezervari i ujit (dëmtim i strukturës)

Mundësitë

- Prezenca e MKRS & Ambasada Amerikane mund të tërheq donatorë të tjerë- atraktive për investime
- Ruajtja dhe shfrytëzimi i lokalitetit për benefite kulturore, ekonomike, mjedisore, shkencore
- Ngritja e kapaciteteve lokale
- Njohja me zhvillimet historike (shtresat kulturore)
- Shkëmbimi i përvojave në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar

Kërcënimet

- Kushtet klimatike (gjeologjike), tërmete (dobësim të lokalitetit)
- Ndërtime të papërshtatshme (nën kalaja)
- Metodat jo profesionale të konservimit/ restaurimit
- Rezervuari i ujit
- Mungesa e sigurisë/ qasje e pakontrolluar
- Mungesa e mirëmbajtjes
- Mungesa e realizimit të planit të konservimit

4.1.2. Edukimi dhe Hulumtimi

Edukimi

Në kalanë e Prizrenit ka vizita të nxënësve të shkollave fillore e të mesme si nga Komuna e Prizrenit, ashtu edhe në vende tjera të Kosovës e rajonit. Megjithatë, këto vizita janë sporadike dhe nuk janë pjesë e planë programeve mësimore. Për këtë kala, edhe pse konsiderohet rezervat arkeologjik, ende nuk ka ndonjë botim të veçantë. Ekzistojnë vetëm copëza shkrimesh nëpër katalogë, raporte e studime. Dobësi tjetër është edhe mungesa e fondeve në aspektin e edukimit për lokalitetin në fjalë. Në lokalitet tashmë është rindërtuar ndërtesa që do të mund ti bëjë vend Qendrës së Interpretimit, qendër kjo që do të mund të shërbente si çerdhe edukimi për gjeneratat e reja. Në të njëjtën kohë, ekziston mundësia e përfshirjes së Kalasë në kurikula mësimore.

Hulumtimi

Në këtë lokalitet arkeologjik të mbrojtur, hulumtimet e para me karakter shkencor janë zhvilluar në fund të viteve të gjashtëdhjeta të shekullit të kaluar. Lidhur me këto hulumtime ekziston raporti të cilin e kanë në dispozicion institucionet por jo edhe publiku i gjerë. Hulumtime janë zhvilluar edhe gjatë viteve 2004 dhe 2011.

Përparësitë

- Kalaja më e madhe në Regjionin Jugor të Kosovës
- Rezervat arkeologjik
- Lokalitet që përfaqëson disa periudha kohore (bronz, romake, antikitet i vone, mesjetare, osmane, te vone)

Dobësitë

- Jo funksionalizimi i Qendrës së Interpretimit
- Shkatërrimi i artefakteve
- Fondet e pakta (vetëm hulumtim, jo edhe edukim)
- Mungesa e studimeve/ botimeve të mirëfillta

Mundësitë

- Studime të vazhdueshme
- Botime shkencore
- Botime për masë të gjerë
- Përfshirja në plan programe mësimore (nivel nacional)
- Universiteti Prizrenit (Master TK – praktikë në KP)

Kërcënimet

- Humbja e vazhdueshme e interesit në TK
- Mungesa e resurseve njerëzore
- Fondet e vogla
- Mos interesimi i MASHT/Komuna
- Pretendimet e pabazuara historike/politike

4.1.3. Zhvillimi Ekonomik dhe i Turizmit

Për Kalanë e Prizrenit, sikurse për shumicën e monumenteve kulturore në Kosovë, mungojnë statistikat, si ekonomike ashtu edhe statistika lidhur me numrin e vizitorëve. Momentalisht, brenda lokalitetit nuk ka ndonjë aktivitet ekonomik. Megjithatë, për shkak të rëndësisë që ka Kalaja, vlerësohet që ka ndikim në prurjen e vizitorëve dhe indirekt në zhvillimin ekonomik të shërbimeve që gjenden për rreth. Në Kala gjithashtu organizohen edhe festivale të cilat në një formë ndikojnë gjithashtu në ngritjen e numrit të turistëve. Për shkak të rëndësisë së saj nacionale, Kalaja mund të bëhet brend i qytetit të Prizrenit dhe të shërben si një qendër kulturore.

Dobësi e madhe e lokalitetit është qasja e vështirësuar dhe e pamundshme për personat me nevoja të veçanta. Infrastruktura është gjithashtu në gjendje jo të mirë. Nga Komuna e Prizrenit deri tash është investuar shumë pak për këtë aset të rëndësishëm të trashëgimisë. Investimi i vetëm ka qenë ndriçimi i murit ballor. Planifikohet që ne te ardhme e afërt të bëhet rehabilitimi i rrugës që dërgon deri në kala.

Përparësitë

- Gjendet në Prizren, qyteti më turistik në Kosovë
- Numër i kënaqshëm i vizitorëve

Dobësitë

- Qasja
- Mungesa e investimeve të koordinuara
- Mungesa e strategjisë zhvillimore
- Infrastruktura e dobët

Mundësitë

- Magnet Turistik - rritja e numrit të turistëve
- Brand i qytetit - copyright
- Atraksion Turistik
- Biznese të vogla
- Lidhjet me nën kala – harmonizimi i shërbimeve
- Festivalet – HUB kulturor

Kërcënimet

- Kalatë tjera në Kosovë po ja marrin primatin (Novobërda)
- Izolimi nga qyteti
- Mos koordinimi i aktorëve
- Plani Menaxhimit joreal

4.1.4. Komunikimi: Prezantimi, Interpretimi dhe Promovimi

Interpretim: Ne lokalitetin e Kalasë dhe në Prizren më gjerësisht është një interpretim jo i mjaftueshëm i Kalasë, ka tabela shënjuese në qytet por nuk janë në nivelin e duhur, janë tri qendra informimi por vetëm njëra është funksionale si dhe Kalaja specifikisht nuk ka interpretim. Plani i interpretimit është duke u elaboruar nga CHwB, i cili ka dalë nga Kampi i Interpretimit i mbajtur në Tetor të 2015.

Promovim/ prezantim: Ka disa publikime, në të cilat ka informacione të cilat janë jo të mjaftueshme për Kalanë. Sa i përket hulumtimeve të lokalitetit, ka shumë pak nga to, nuk ka ka qasje si dhe mungojnë informata gjithëpërfshirëse. WEB faqja dhe Facebook faqja që kanë dalë nga kampi janë në punim e sipër. Sa i përket video-ve, ekziston video dokumentari nga arkiva e RTK-së si dhe storjet e incizuara gjatë kampit. Kalaja më së shumti promovohet gjatë aktiviteteve të Dokufestit në lokalitet. Megjithatë, lokaliteti i kalasë është mjaft atraktiv dhe i rëndësishëm dhe si i tillë jep mundësi të shumta për promovimin dhe prezantimin adekuat të tij.

Përparësitë:

- Plani i Interpretimit
- Lokalitet atraktiv
- Pozite e volitshme për zhvillimin e aktiviteteve
- Shtresat arkeologjike
- Posedimi i tri qasjeve për në kala
- Ka vizitorë në lokalitet

Dobësitë:

- Qasja e vështirësuar deri dhe brenda kalasë
- Mungesa e informimit kreativ
- Mungesa e aktiviteteve
- Mungesa e informacioneve, dokumenteve te sakta
- Ciceronët
- Mungesa e udhëzuesve të interpretimit

Mundësitë:

- Organizimi i aktiviteteve kulturore, sportive, rekreative
- Mundësi integruese me qytetin
- Mundësi e krijimit te pakove turistike
- Lidhja me muzetë ekzistues
- Lidhja me kalatë regjionale

Rreziqet:

- Menaxhimi dhe mirëmbajtja e strukturave ekzistuese
- Menaxhimi i elementeve te interpretimit
- Plane te mirëfillta
- Humbja e interesimit

4.1.5. Korniza Institucionale dhe Ligjore

Korniza Ligjore: Në Kosovë ka legjislacion të rregulluar për lokalitet e mbrojtura, si Ligji mbi Trashëgiminë Kulturore, Ligji për Planifikim Hapësinor, etj. por nuk ka udhëzues për konservim, menaxhim, adaptim etj. Kalaja ka status të mbrojtjes ligjore, është lokalitet arkeologjik, sipas Listës së TK nën mbrojtje të Përkohshme. Sidoqoftë, lokaliteti në fjalë nuk e ka perimetrit dhe buffer zonën e definuar. Kalaja e Prizrenit gjendet brenda qendrës historike të Prizrenit. Plani i Konservimit dhe zhvillimit të Qendrës Historike të Prizrenit është i miratuar dhe zbatohet.

Korniza Institucionale: Kalaja nuk ka menaxhim në vend. Si lokalitet i mbrojtur është nën menaxhimin e MKRS-së. Ajo është në pronësi të Komunës së Prizrenit, e cila në të njëjtën kohë është përfituese. Problemi kryesor në lokalitet është që mungon korniza institucione, e me këtë mungon edhe definimi i detyrave apo përgjegjësi të institucioneve relevante, si Komunës, QRTK-së, etj. Si trup i rëndësishëm, është Këshilli i qendrës historike të Prizrenit që shërben si organ këshillëdhënës. Element mjaft pozitiv është interesimi i shoqërisë civile për zhvillimet në Kala.

Përparësitë

- Mbrojtja ligjore- legjislacioni, statusi
- Gatishmëria e palëve të interesimit për menaxhim

Dobësitë

- Mungesa e menaxhimit të lokalitetit (site menaxhim)
- Mungesa e kornizës së miratuar institucionale
- Mungesa e udhëzuesve për konservim, menaxhim, mirëmbajtje
- Mungesa e perimetrit dhe bufferit
- Mungesa e komunikimit ndër-institucional dhe institucional me shoqërinë civile
- Mungesa e inspektimit të rregullt

Mundësitë

- Kornize institucionale gjithëpërfshirëse
- Hartimi i udhëzuesve
- Zbatimi i plotë i mbrojtjes ligjore (buffer dhe perimetrit)

Rreziqet:

- Degradimi i lokalitetit (perimetri dhe buffer zona)
- Humbje e vlerave si mungesë e bashkëpunimit të institucioneve

Për fushat e veprimt të analizuar më lartë, SWOT analiza dhe përshkrimi i gjendjes është bërë në punëtori të organizuar me Grupin e Palëve të Interesit. Për fushat e veprimt të analizuar më poshtë, janë bërë takime të veçanta më përfaqësues të Komunës së Prizrenit, respektivisht Departamentit të Shërbimeve Publike, Departamentit të Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Emergjencës dhe Sigurisë, Buxhet dhe Financa si dhe Departamentit për Zhvillim dhe Turizëm. Përfaqësuesit e Departamenteve në fjalë, nuk kanë qenë prezent në punëtoritë në të cilat është bërë analiza SWOT për kalanë e Prizrenit. Për këtë arsyeje, fushat e mëposhtme nuk kanë SWOT analizë, por vetëm përshkrim të gjendjes e cila është nxjerrë në takimet me përfaqësuesit e Komunës, të përshkruar më lartë.

4.1.6. Infrastruktura

Ekzistojnë tri qasje për në Kala: Rruga e Marashit, rruga nga Shatërvani dhe Pantelia. Rruga e Marashit përdoret zakonisht për rekreacion dhe është e gjatë afërsisht 1 orë në këmbë deri kala. Rruga që përdoret për qasje me automjete është ajo e Pantelisë. Asnjëra nga këto rrugë nuk i plotëson kushtet për persona me nevoja të veçanta. Lëvizja brenda kalasë është gjithashtu e vështirësuar, sidomos për persona me nevoja të veçanta. Projekti i PM Group ka paraparë disa shtigje për ecje brenda Kalasë, të cilat janë duke u ndërtuar.

Projekti i interpretimit nga CHwB ka dizajnuar shtegun brenda Kalasë, i cili përfshin një pjesë të madhetë strukturës dhe është komfort standarde për persona me nevoja të veçanta. Në kala ka instalime të rrymës dhe ujit por nuk ka sistem të kanalizimit.

Drejtoria e Zhvillimit të Turizmit brenda Komunës së Prizrenit do të implementojë projektin për rregullimin e shtegut prej Shkollës së Muzikës deri tek porta e Kalasë. Ky projekt përfshin vendosjen e ndriçimit në rrugë dhe të kalasë nga jashtë, tre vendpushimeve, ulëseve, shportave të mbeturinave, kanalizimit dhe materialit të rrugës. Projekti është përfunduar, tani do të hapet tenderi për implementimin e punëve, që planifikohen të përfundojnë para festivalit të Dokufestit.

4.1.7. Mjedis

Brezi i nënklasë gjendet në zonën historike të Prizrenit. Drejtoria e Urbanizmit gjatë dhënies së lejes për zhvillim në këtë zonë konsultohet me njësinë e mjedisit nëse zhvillimi i ri i plotëson kushtet në aspektin mjedisor. Çfarëdo zhvillimi që mund të ndikon negativisht në mjedisin e Kalasë i nënshtrohet VNM-së. Nuk ka mekanizëm për evidentimin e turistëve në kala.

4.1.8. Menaxhimi i Kanosjeve

Sipas Drejtorisë së Emergjencave pranë Komunës së Prizrenit nuk ka ndonjë rrezik për Kalanë që mund të shkaktohet nga ndërtimet e reja në nën kala apo nga numri i madh i turistëve. Ekziston Plani i Operacioneve Emergjente 2014 i elaboruar nga Komuna e Prizrenit, i cili nuk ka analiza specifike dhe propozime për menaxhim të rreziqeve në Kala.

4.1.9. Planifikimi Hapësinor

Ekziston Plani i përgjithshëm (gjeneral) urbanistik 2003-2013, i hartuar nga Nixha & Partners me afat të skaduar, i cili aplikohet deri në hartim të Hartave Zonale. Sipas këtij plani, kalaja gjendet në zonën e parë të mbrojtur. Plani Zhvillimor Komunal (Hartuar nga Universiteti teknik i Stambollit, Qendra Hulumtuese për urbanizëm dhe planifikim ambiental, Stamboll, Urban Design Studio, Prizren, Plan-Art, Stamboll) është në fuqi. Në Planin e Konservimit dhe Zhvillimit Kalaja nuk përfshihet, meqë nuk është në kufijtë e zonës historike. Sidoqoftë, ajo trajtohet me Ligjin për Zonën Historike.

Teleferiku për në kala ka qenë iniciative e Drejtorisë së Urbanizimit, por ky projekt ka dështuar. Lejet që jepen për zhvillime në zonën e nën kalasë bazohen në kriteret e dalës nga Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Prizrenit.

5. HISTORIA DHE PËRSHKRIMI

5.1. Përshkrim i shkurtër i lokalitetit

Kalaja e Prizrenit përmban në vete një pjesë të rëndësishme të historisë së lashtë të qytetit. Pozicioni i saj topografik, dominues mbi qytetin, peizazhi natyror mjaft tërheqës dhe konfigurimi arkitektonik i menduar mjaft mirë, e bëjnë këtë lokalitet me vlera të padiskutueshme ambientale, shkencore, historike dhe turistike. Si një pasuri e trashëguar nga perandoria Bizantine, Kalaja shtrihet në anën juglindore të qytetit, e ndërtuar në një kodër mbi 120 metra në anën e majtë të lumit Lumbardh. Funkcioni kryesor i kalasë ishte fortifikim i cili ka shërbyer për të mbrojtur popullin nga sulmet e pushtuesve të ndryshëm. Ajo është përdorur si fortesë deri në vitin 1912. Gërmimet arkeologjike të kryera në vitin 1969 dhe përsëri në vitin 2004, 2009-2011, kanë rezultuar në zbulimin e infrastrukturës, të paraqitur me mure të përforcuar me kulla, kazamate, labirinte, depo dhe një gamë të objekteve në kuadër të strukturës. Në aspektin e ndërtimit, kalaja përbëhet nga tre komplekseve të veçanta, të njohura si Qyteti i Epërm, Qyteti i poshtëm dhe Qyteti Jugor, ndërsa në aspektin e fortifikimit gjatë shekujve, ajo i takon periudhave të ndryshme, si periudha antike, periudha e sundimit bizantin, periudha mesjetare dhe periudha e sundimit të Perandorisë Osmane. Sipas kopjes së planit, lokaliteti është në pronësi të Komunës së Prizrenit. Ky lokalitet ka mbrojtje ligjore dhe është shpallur aset i mbrojtur i trashëgimisë kulturore. Gërmimet dhe punët konservuese janë duke u ndërmarrë nga Instituti Arkeologjik i Kosovës. Kalaja e Prizrenit është përdorur edhe si një atraksion turistik për qytetarët e Prizrenit, si dhe për shfaqjen e filmit gjatë Dokumentarit vjetor Ndërkombëtar dhe Festivalit të Filmit të Shkurtër "Dokufest".

5.2. Mbrojtja ligjore

Gjatë periudhës 1948-1999 kalaja ishte i mbrojtur në nivel kombëtar. Ajo ishte e klasifikuar si monument I 'kategorisë së parë'.² Kalaja e Prizreni është një lokalitet i mbrojtur arkeologjik që nga viti 1967. Lokaliteti është në Listën e Trashëgimisë Kulturore në mbrojtje të përkohshme të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. (Vendimi me numër 1585/48, MKRS, 2014) Ky lokalitet është i mbrojtur nga Ligji mbi Trashëgiminë Kulturore (Nr. 02 / L-88), Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura (Nr 03 / L-039) dhe Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit (Nr. 04 / L-066). Në nivelin lokal, në dhjetor 2008, Komuna e Prizrenit ka miratuar Planin e Zhvillimit dhe Konservimit të Zonës Historike të Prizrenit (2008), i cili shërben plan rregullues për zonën historike të Prizrenit. Kalaja e Prizrenit nuk trajtohet në ndonjërin nga zonat e përcaktuara me plan.

5.3. Historia

Pozita e Kalasë, duke dominuar qytetin, peizazh shumë tërheqës natyror dhe mjedis arkitektonik, e bën të padiskutueshme rëndësinë e saj. Megjithatë, ka shumë pak burime të shkruara për Kalanë e Prizrenit. Emri i kalasë u regjistrua për herë të parë nga një studiues bizantin, Prokopi i Cezaresë, në veprën "De aedificiis".³ Në veprën e tij, në mesin e fortifikimeve të rinovuara në Dardani, kjo kala është evidentuar për herë të parë, e quajtur Petritzen, emrin që sot e mban qyteti i Prizrenit.⁴ Kalaja është ndërtuar në gurë natyral. Në kohët e lashta ajo është përdorur si një fortesë ushtarake. Në afërsi të saj u zbuluan vendbanime të epokës neolitike dhe qeramike dhe armë ilire. Gjatë Perandoria Romake, qyteti origjinal ilir i Therandës u zhvillua si një garnizon në afërsi të kështjellës. Para

Perandorisë Osmane, kalaja ishte e ndërtuar si një fortifikim për të mbrojtur popullin nga sulmet e pushtuesve të ndryshëm.⁵ Në shumicën e qyteteve të Rumelisë të pushtuar nga Perandoria Osmane, kështjellat dhe fortesat e Perandorisë Bizantine pas restaurimeve janë përdorur si garnizone ushtarake.⁶ Gjatë periudhës osmane, kështjella është përdorur vazhdimisht. Gjatë sundimit të Mehmet Pashës (1809-1836), Kulla e Sahatit u ndërtua në kështjellë, e përcjellë nga një xhami, e ndërtuar në vitin 1828. Është e mundur që ndërtesa u ngrit për herë të parë në gjysmën e dytë të shekullit të 15-të pas pushtimit të Prizrenit nga osmanët në vitin 1455.⁷

Pas pushtimit të Prizrenit, Perandoria Osmane i përqendroi të gjitha forcat ushtarake në kalanë e qytetit. Pas disa ndërhyrjeve në strukturë e deri në tërheqjen përfundimtare të Perandorisë Osmane, Kalaja ka shërbyer si qendër kryesore e forcave ushtarake.⁸ Në kala, me përjashtim të njësie speciale ushtarake, u ndërtua një hapësirë për arsenalin ushtarak dhe më pas një burg. Në qytetin e ulët, ku kazamatet jugperëndimore dhe perëndimore janë të lidhura, u vendosën topat-Gjylet. Një nga topat e mbetur nga periudha osmane ende ekziston në të njëjtin vend. Në këtë pjesë ka qenë një sënduk armësh, me disa armë që ende ekzistojnë në të njëjtin vend. Kalaja ka pasur këto njësi: këmbësorët, kalorësinë, artilerinë dhe njësi të tjera ushtarake osmane. Sipas të dhënave, në kazermat e kështjellës ndër të tjera, ka qëndruar edhe regjimenti II i batalionit të Sulltanit II. Gjatë periudhës kur Prizreni ishte qendra e vilajeteve, kalaja kishte 2818 ushtarë këmbësorie dhe 836 ushtar kalorësie. Kështu në atë kohë, garnizoni i Prizrenit kishte më shumë ushtarë se ato në Nish, Shkup dhe Dibër.⁹ Në vitin 1912, kur Prizreni u mor nga ushtria serbe, kalaja dhe të gjitha ndërtesat e tjera u shkatërruan.¹⁰ Menjëherë pas luftës në Kosovë, forcat e KFOR-it Gjerman që kanë shërbyer nën NATO-s kanë qëndruar në kështjellë për dy vjet e gjysmë dhe zona përreth kështjellës u shpall një zonë të ndaluar. Në verën e vitit 2003 forcat gjermane të KFOR-it e braktisën kështjellën dhe që nga ajo kohë, lokaliteti ishte i hapur për qytetarët e Prizrenit.¹¹

5.4. Dokumentacioni i gjendjes ekzistuese

Raporti i gjendjes ekzistuese (2015-2016) nga CHwB, si pjesë e projektit 'Ruajtja e Kalasë së Prizrenit'.

5.5. Fotografi

Fotografi të vjetra dhe të reja.

5.6. Publikime

- European Commission/ Council of Europe (2009) Preliminary Technical Assessment of the Architectural and Archaeological Heritage in South East Europe. Prizren Fortress (Kalaja) Prizren.

European Commission/ Council of Europe (2006) Preliminary Technical Assessment of the Architectural and Archaeological Heritage in South East Europe. *Prizren Fortress (Kalaja) Prizren*.

³Ibid.

⁴Ministry of Culture, Youth and Sport (2015) Cultural Heritage Database. Prizren Castle. Available at: http://dtk.rks-gov.net/tkk_objekti.aspx?id=6229

- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (2015) Databaza e Trashëgimisë Kulturore. Kalaja e Prizrenit. Në dispozicion: http://dtk.rks-gov.net/tkk_objekti.aspx?id=6229
- Virmiça, R. (1999) Kosova'da Osmanli Mimari Eserleri, Ankara.
- Document for the revitalization of Cultural Heritage of Prizren, Institute for Urbanism and Protection of Cultural and Natural Monuments, Prizren, March 1970.
- Deroko A., Srednjovekovi Gradi u Srbija, Makedonija i Crna Gora, 1950.
- Haskuka E., Historical - geographic analysis of urban functions in Prizren, Gakovica 1985.
- Jovanović V., Archaeological researches on medieval monuments and emplacements in Kosovo, Belgrade 1988.
- Kovačević J., Archaeological excavations and researches of Kalaja / Fortress, 1969 - Preliminary report, Beograd – Prizren, 1970.
- Nešković J., Architecture and cities of Serbia in the 19th century, Rashka, t.25, 1989.
- Nikolić S., Prizren since medieval centuries until contemporary era, Prizren 1998.
- Shukriu M., (2001) Prizreni i Lashte, Prizren.
- Zdravković I., Srednjovekovi Gradovi i Dvorci na Kosovu, Belgrade, 1975.
- Hoxha, G. & Përzhita, L. (2008) Iliria Revistë Arkeologjike. Qendra e studimeve albanologjike. Instituti i Arkeologjisë.
- MKRS & IAK (2012) Guida Arkeologjike e Kosovës.

5.7. Materialet arkivore

- RTK (Rreth 1980) Dokumentar për Kalanë e Prizrenit.
- Fotografi të vjetra dhe harta.
- Raporte, projekte, dokumentacioni teknik dhe fotografik dhe publikime mund të gjenden në arkivat e Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore Prizren (QRTK - Prizren).

5.8. Rezultatet e hulumtimeve paraprake

- Projekti i revitalizimit të Kalasë së Prizrenit nga PM Group (2011)
- Raporte të hulumtimeve arkeologjike të vitit 1969 (Prof. Dr. Jovan Kovačević)
- Raporte të gërmimeve arkeologjike të vitit 2004 (Gëzim Hoxha dhe Luan Përzhita)

⁵Virmiça, R. (1999) Kosova'da Osmanli Mimari Eserleri, Ankara.

⁶Ibid.

⁷CHwB (2011) Conservation and Development Plan for the Historic Zone of Prizren. Kosovo: CHwB.

⁸Virmiça, R. (1999) Kosova'da Osmanli Mimari Eserleri, Ankara.

⁹Ibid.

¹⁰CHwB (2011) Conservation and Development Plan for the Historic Zone of Prizren. Kosovo: CHwB.

¹¹Virmiça, R. (1999) Kosova'da Osmanli Mimari Eserleri, Ankara.

5.9. Dëmtimet

Kalaja është e ekspozuar vazhdimisht ndaj kushteve klimatike: lagështisë, temperaturave të ngrirjes, ngrohjes dhe bimësisë të bollshme, të cilat nga kompleksiteti i tyre sistematikisht dëmtojnë kalanë. Faktor tjetër destruktiv është mungesa e mbrojtjes dhe lëvizja e lirë dhe e pakontrolluar e vizitorëve mbi muret e kalasë, e cila dëmton muret periferike dhe muret e objekteve të tjera në kuadër të kalasë. Kalaja rrezikohet nga një numër i madh i kërcënimeve për momentin. Një kërcënim i mundshëm mund të jenë zhvilluesit që pretendojnë ndërtimin një teleferik lokal dhe rrugë të madhe të asfaltit pranë lokalitetit. Gjithashtu, në dy dekadat e fundit është propozuar ndërtimi i një hoteli modern në lokaliteti. Mungesa e një plani të menaxhimit do të shpie në ndërtesa të paplanifikuara në strukturë. Ka mungesë e udhëzimeve/ shenjave për vizitorët, dhe nuk ka asnjë shenjë që tregon se lokaliteti është një aset i mbrojtur. Ka nevojë të madhe për kufizime, se ku mund të lëvizin njerëzit në këtë lokalitet dhe një nevojë për mure anësore mbrojtëse. Qasja përmes rrugës për në kala nuk është adekuate. Ka mungesë të parkingut dhe nuk ka zona të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara.

5.10. Punët e mëparshme konservuese apo restauruese

Në vitin 1798 përfaqësuesi i Prizrenit, Rustem Pasha me ndihmën e shërbëtorëve të tij kishte restauruar kështjellën. Para Rustem Pashës, disa përfaqësues duke përfshirë edhe ata nga Prizreni kishin shtëpitë verore në kështjellë.¹² Nga viti 1808, kalaja ka qenë në gjendje të mirë dhe në të njëjtin vit Emin Pashë Rotulli ndërtoi xhaminë. Rinovimi i xhamisë është bërë nga Mahmut Pashë Rotulli në 1828. Gjatë kësaj kohe Kulla e Sahatit u ndërtua gjithashtu (ora dhe zilja u sollën nga Smedereva).¹³

Sipas Raif Virmicës, në vitin 1831 Mahmut Pasha e restauroi kalanë dhe xhaminë, e cila u shkatërrua gjatë luftës austro-osmane. Në atë kohë u rindërtua edhe Kulla e sahatit.¹⁴ Kalaja e Prizrenit është përdorur ekskluzivisht si fortifikim ushtarak deri në vitin 1882, kur disa premise ushtarake u ndërtuan në pjesën perëndimore të qytetit. Kalaja ka vazhduar të përdoret si depo për armë, burg dhe por kishte edhe përdorime të tjera dytësore. Përkeqësimi i shpejtë i kalasë filloi pas vitit 1914. Në vitin 1938 një rezervuar uji ishte vendosur në afërsi të korridorit të mbuluar perëndimor.¹⁵ Gërmimet arkeologjike të kryera në vitin 1969 dhe përsëri në vitin 2004, 2009-2011, kanë rezultuar në zbulimin e infrastrukturës, të paraqitur me muretë përforcuar me kulla, kazamate, labirinte, depo dhe një gamë të objekteve në kuadër të strukturës. Vazhdimi i gërmimeve arkeologjike në vitin 2004 dhe 2009/2011 rezultoi në zbulimin e një vendbanimi prehistorik nga periudha e bronzit të vonë dhe periudha e hershme e Hekurit, që shërbeu si bazë e parë e jetesës në këtë vend. Gjithashtu për herë të parë këto gërmime zbuluan gjurmë të arkitekturës dhe dëshmi të materialit të datueshëm romak dhe antikitetit të vonë. Gjatë periudhës osmane, kalaja u zgjerua me mure fortifikuese të ndërtuara, përforcuara dhe pasuruara me ndërtesa të reja si hamami, xhamia dhe ndërtesa të tjera për nevoja ushtarake. Renovimi i saj i fundit është bërë në dekadën e tretë të shekullit të 19-të, nga familja lokale borgjezie Rotllaj. Në periudhën 2008-2010 disa punë konservuese - restauruese filluan si masë emergjente për të parandaluar procesin degraduese të kështjellës.¹⁶ Ndërhyrjet në kështjellë, të ndërmarra gjatë viteve të 50-ta janë përqendruar kryesisht në regjistrim gjeodezik. Në vitin 1969 janë bërë gërmimet e para arkeologjike. Në të njëjtën kohë është bërë draftimi i planit të adaptimit të kalasë. Gërmimet arkeologjike kanë vazhduar në vitin 2004, 2009 – në proces e sipër. Puna në terren

e kryer deri më tani përfshin:

- (1) Punët restauruese- konservuese në vitin 1963 dhe 1964.
- (2) Gërmimet arkeologjike dhe konservimi në vitin 1969, nga IMMK Serbi dhe IMMK Kosovë
- (3) Nga 1969 deri më 1999 intervenime të vogla janë kryer në bastionet dhe pjesë të caktuara të kalasë për të parandaluar shkatërrimin e saj të mëtejshëm. Gjatë kësaj periudhe nuk janë ndërmarrë punime globale për mbrojtjen e bastioneve dhe pjesëve të kalasë.
- (4) Një rrugë është ndërtuar nga kisha e Shën Trinisë deri në hyrje të kalasë, së bashku me vendosjen e ndriçimit elektrik, në vitin 2003.
- (5) Gërmimet arkeologjike dhe pastrimi i pjesshëm i bimësisë në vitin 2004.
- (6) Që nga viti 2009, gërmimet arkeologjike dhe konservimi i strukturave financohet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe implementohet nga Instituti Arkeologjik i Kosovës.¹⁷

Nga gërmimet e fundit në kala, shumë ndërhyrje të kryera në periudha të ndryshme kohore janë vërejtur. Këto ndërhyrje janë kryer kryesisht në shekullin e 16-të dhe 17-të. Në shekullin e 16-të, Perandoria Osmane pas ndërhyrjeve që ndajnë qytetin e sipërm dhe qytetin e poshtëm të kalasë, i ndërtoi dy kulla drejtkëndëshe. Ndërsa në shekullin e 17-të intervenimet kanë ndikuar në masë të madhe në rritjen dhe ndryshimin e formës së përgjithshme të kalasë. Në anën lindore të kalasë është ndërtuar një tunel, ndërsa në anën jugore të qytetit të sipërm, u krijua qyteti i poshtëm. Në mesin e këtyre ndërhyrjeve janë përfshirë mbajtësve të kazamateve në mes të qytetit të epërm dhe atij të poshtëm. Edhe në veri, në veriperëndim dhe verilindje u ndërtuan kazamate tjera anësore. Një nga kazamatet e ndërtuara në anën perëndimore të qytetit të ulët u restaurua pasi që ishte mjaftë e dëmtuar. Gjatë gërmimeve të vitit 1969, u zbuluan gjurmë të xhamisë së shekullit të 19-të. Gjithashtu u zbulua se një tjetër xhami e shekullit të 16-të ka ekzistuar në të njëjtin vend. Deri më sot pjesët më të ruajtura të kalasë janë ato që ishin restauruar gjatë shekullit të 16-të dhe 17-të. Në shekullin e 19-të, dhoma të veçanta u ndërtuan brenda kazamateve. Këto dhoma janë përdorur si burgje, ose janë ndërtuar vetëm për t'i rezistuar shkatërrimit.¹⁸

¹²Virmiça, R. (1999) Kosova'da Osmanli Mimari Eserleri, Ankara.

¹³European Commission/ Council of Europe (2009) Preliminary Technical Assessment of the Architectural and Archaeological Heritage in South East Europe. *Prizren Fortress (Kalaja) Prizren*.

¹⁴Virmiça, R. (1999) Kosova'da Osmanli Mimari Eserleri, Ankara.

¹⁵European Commission/ Council of Europe (2009) Preliminary Technical Assessment of the Architectural and Archaeological Heritage in South East Europe. *Prizren Fortress (Kalaja) Prizren*.

¹⁶Ministry of Culture, Youth and Sport (2015) Cultural Heritage Database. Prizren Castle. Available at: http://dtk.rks-gov.net/tkk_objekti.aspx?id=6229

¹⁷European Commission/ Council of Europe (2006) Preliminary Technical Assessment of the Architectural and Archaeological Heritage in South East Europe. *Prizren Fortress (Kalaja) Prizren*.

¹⁸Virmiça, R. (1999) Kosova'da Osmanli Mimari Eserleri, Ankara.

6. PALËT E INTERESIT

6.1. Identifikimi i palëve të interesit dhe roli i tyre

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit- institucion qendror përgjegjës për ruajtjen dhe menaxhimin e aseteve të trashëgimisë kulturore në Kosovë;

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nën të cilin është Këshilli i Planifikimit Hapësinor, Instituti i Planifikimit Hapësinor dhe Departamenti i Planifikimit Hapësinor. Kjo ministri ka për detyrë të bën integrimin e trashëgimisë kulturore në planet hapësinore.

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor- është një institucion i pavarur, i themeluar nga Kuvendi i Kosovës, në bazë të nenit 142 të Kushtetutës dhe të nenit 4.8 të Ligjit të Trashëgimisë Kulturore ka rol për mbështetjen e Kuvendit për politikën dhe legjislacionin që procedohen nga Qeveria gjegjësisht MKRS, shqyrton, miraton, refuzon propozimet për mbrojtje të trashëgimisë kulturore

Komuna e Prizrenit – pronar i Kalasë së Prizrenit, institucion lokal përgjegjës për menaxhimin dhe zhvillimin e qytetit të Prizrenit, pjesë e së cilit është edhe Kalaja.

Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB) përgjegjës për hartimin e Planit të Adaptimit, Interpretimit dhe Menaxhimit të Kalasë

Instituti Arkeologjik i Kosovës është përgjegjës për gjurmimin dhe konservimin e strukturave të Kalasë.

Ambasada e SHBA në Prishtinë- donatorë i Projektit të Konservimit, Adaptimit, Interpretimit dhe Menaxhimit të Kalasë së Prizrenit.

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturor në Prizren – institucion vartës i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, përgjegjëse për ruajtjen, restaurimin dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore në Komunën dhe regjionin e Prizrenit;

Këshilli për Trashëgimi Kulturor të Prizrenit – i themeluar në bazë të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit (Ligj Nr. 04/L-066) është trup përgjegjës për mbikëqyrjen dhe këshillimin rreth aktiviteteve të zhvilluara brenda kufijve të zonës historike të Prizrenit;

Rrjeti i Organizatave të Kulturës (ROK)- rrjet joformal i organizatave të kulturës aktive në Komunën e Prizrenit. Ky rrjet përbëhet nga 23 organizata jo-qeveritare të cilët kanë për qëllim pasurimin e sektorit kulturor, rritjen e kualitetit të aktiviteteve ekzistuese kulturore dhe përmirësimin e politikave kulturore në nivel lokal;

OJQ EC MA Ndryshe – qëllimet kryesore të kësaj organizate janë promovimi i qytetarisë aktive dhe pjesëmarrëse dhe ngritja e vetëdijes qytetare për mbrojtjen dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore.

Dokufest- është një OJQ e cila organizon festivalin vjetor ndërkombëtar të filmave dokumentarë dhe atyre të shkurtër "Dokufest". Kalaja e Prizrenit përdoret gjatë dokufestit për shfaqjen e filmave.

Akea – Asociacioni për Kulturë, Edukim dhe Arsimin i cili organizon aktivitete të shumta kulturore dhe humanitare në Komunën e Prizrenit.

Bashkësia Islame e Kosovës në Prizren

Banorët lokal, pronarët, shfrytëzuesit dhe përfituesit.

Ekspertët- hulumtime, studime, dokumentime dhe mbikëqyrje

Komuniteti i biznesit- ofrojnë shërbime, tërheqin vizitorët.

Donatorët- mbështetja financiare, ngritja e kapaciteteve, monitorimi

Shoqëria civile- Monitorim, mbështetje në promovimin dhe ngritjen e fondeve

Mediat (promovimi, edukimi, ngritja e vetëdijes).

Ministria e Arsimit, Shkencave dhe Teknologjisë- përfshirja e trashëgimisë kulturore në kurrikulat shkollore.

Muzetë në Prizren.

Turistët dhe vizitorët, shfrytëzuesit e shërbimeve turistike.

Policia, zjarrfikësit, ambulance.

6.2. Grupimi i palëve të interesit në tri grupe sipas ndikimit të tyre në plan

6.2.1. Palët e interesit që drejtpërdrejt ndikojnë në Plan

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
Komuna e Prizrenit;
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore;
Instituti Arkeologjik i Kosovës;
Këshilli për Trashëgimi Kulturore të Prizrenit;
Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore (Prizren);
Banorët lokal, pronarët, shfrytëzuesit dhe përfituesit
Ekspertët- hulumtime, studime, dokumentime dhe mbikëqyrje;
Komuniteti i biznesit, ofrojnë shërbime, tërheqin vizitorët.
Donatorët- mbështetja financiare, ngritja e kapaciteteve, monitorim;
Shoqëria civile- Monitorim, mbështetje në promovimin dhe ngritjen e fondeve.

6.2.2. Neutral, por të interesuar për planin

Mediat (promovimi, edukimi, ngritja e vetëdijes);
Ministria e Arsimit, Shkencave dhe Teknologjisë- përfshirja e trashëgimisë kulturore në kurrikulat shkollore;
Muzetë në Prizren.

6.2.3. Palët e interesit jo relevant apo pa ndikim në Plan

Turistët dhe vizitorët, shfrytëzuesit e shërbimeve turistike;
Policia, zjarrfikësit, ambulancat.

7. PLANI I VEPRIMIT (Tabela e detajuar e bashkëngjitur ne aneks 1)

PLANI I VEPRIMIT PËR KALANË E PRIZRENIT	
1. KONSERVIMI DHE ADAPTIMI	
NR.	AKTIVITETET
1.1	TË PËRCAKTOHET PLANI I KONSERVIMIT PËR PJESËT E PA TRAJTUARA TË KALASË (PAS GËRMIMEVE ARKEOLOGJIKE ME KARAKTER PASTRIMI), DUKE PASUR PARASYSH ZONAT E HULUMTUARA DHE TË PA HULUMTUARA QË PARAQESIN POTENCIAL PËR GJENERATAT E PROFESIONISTËVE TË ARDHSHËM
1.1.1	Definimi i zonave të trajtuara dhe pa trajtuara të kalasë
1.1.2	Përpilimi i raporteve preliminare si bazë për përpilimin e Planit të Konservimit;
1.1.3	Forcimi i partneriteteve me institucionet edukative – Shkolla Arkeologjike
1.1.4	Përpilimi i Planit të Konservimit duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe pjesëmarrjen
1.2	TË BËHET ADAPTIMI I KALASË, SI MUNDËSI PËR RRRITJEN E ATRAKTIVITETIT TË LOKALITETIT, VËNIEN E FUNKSIONEVE ADEKUATE NË SHËRBIM TË TURIZMIT KULTUROR DHE TË OFRIMIT TË MUNDËSIVE PËR ZHVILLIMIN E ARTIZANALEVE, NË SHËRBIM TË RUAJTJES SË TRADITËS
1.2.1	Hartimi i planit të adaptimit për pjesët e strukturave që janë konservuar, duke u bazuar në kërkesat e grupeve të interesit dhe kërkesave të dala nga sondazhet;
1.2.2	Pilotim rreth funksionalizimit të hapësirave të adaptuara në bashkëpunim me grupet e interesit;
1.2.3	Zbatimi i planit të adaptimit në disa pjesë me prioritet të Kalasë;
1.3	TË PËRMIRËSOHET KOMUNIKIMI NDËR-INSTITUCIONAL PËRMES RRRITJES SË TRANSPARENCËS, MONITORIMEVE DHE RAPORTIMEVE PERIODIKE
1.3.1	Organizimi i takimeve të përbashkëta me karakter informimi
1.3.2	Përpilimi i kalendarit të aktiviteteve dhe raportimi vjetor
2. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE	
2.1	TË DEFINOHET ZONA PËR KONSERVIM NË KALA
2.1.1	Hartimi i dokumentacionit për mbrojtje
2.1.2	Definimi i autenticitetit/integritetit të asetit
2.1.3	Përcaktimi i nivelit të ndërhyrjeve
2.2	TË BËHET MENAXHIMI EFEKTIV I LOKALITETIT
2.2.1	Definimi i modelit për menaxhim- Krijimi i trupit menaxhues
2.2.2	Marrëveshja për themelim (përgjegjësitë dhe financimi) e njësisë menaxhuese
2.2.3	Hartimi i statutit dhe rregulloreve të brendshme të njësisë menaxhuese
2.2.4	Jetësimi/ vënia në jetë e njësisë menaxhuese
3	TË HARTOHEN STANDARDET DHE UDHËZUESIT PËR NJËSINË MENAXHUESE
3.1	Identifikimi dhe adaptimi i standardeve
3.2	Trajnimi i stafit
3. EDUKIMI DHE HULUMTIMI	
3.1	TË THEMELOHEN INSTITUCIONET QË PUNOJNË NË PREZANTIMIN E KALASË
3.1.1	Themelimi i Qendrës së Interpretimit/ Muzeut

PLANI I MENAXHIMIT PËR KALANË E PRIZRENIT

3.1.2	Krijimi i sektorëve për ruajtjen (që përfshin mbledhjen, konservimin dhe menaxhimin e koleksioneve), hulumtimin, dhe komunikimin (edukimi dhe ekspozimi).
3.1.3	Krijimi i ekspozitave permanente dhe të përkohshme, interaktive, bashkëkohore dhe gjithëpërfshirëse
3.1.4	Krijimi i materialeve promovuese dhe informuese
3.1.5	Krijimi i listës së aktiviteteve me fëmijë, të rinjë e të moshuar
3.1.6	Ngritja e kapaciteteve të punëtorëve të qendrës
3.1.7	Kurator
3.1.8	Konservator
3.1.9	Arkivist
3.1.10	Interpretues
3.2	TË RRITET NUMRI I HULUMTIMEVE DHE BOTIMEVE SHKENCORE
3.2.1	Marrëveshje me institucionet arsimore dhe shkencore (UP, UPZ, ASHK, IAK, IHK, IAP) për të vënë theks të veçantë në Kala
3.2.2	UP, UPZ, IAK - Hulumtime arkeologjike sistematike/ Shkolla e arkeologjisë
3.2.3	Krijimi i mundësive për praktikë pune në kala
3.2.4	ASHK, IAP, IHK - Hulumtime arkivore dhe publikime
3.2.5	Prezantimi i vazhdueshëm i publikimeve të rëndësishme për kalanë
3.2.6	Organizimi i konferencës shkencore vjetore
3.2.7	Krijimi i databazës së Kalasë
3.2.8	Bashkëpunimi me institucione të huaja relevante
3.3	TË RRITEN INVESTIMET E JASHTME NË FUSHËN E EDUKIMIT DHE HULUMTIMIT
3.3.1	Hulumtimi i instrumenteve financiare potenciale
3.3.2	Përgatitja e aplikacioneve dhe aplikimi për fonde
3.3.3	Krijimi i lehtësimeve për investim në kala nëse investojnë në sektorin e edukimit
4.	ZHVILLIMI EKONOMIK DHE TURIZMI
4.1	TË TRAJTOHET QASJA FIZIKE NË KALA
4.1.2	Hartimi i projektit të fizibilitetit për instalim të teleferikut
4.1.3	Studim fizibiliteti për rrugën e Pantelisë
4.1.4	Studim fizibiliteti për qasje të shpejtë në Kala
4.2	TË GJENEROHEN TË ARDHURA, NË MËNYRË QË KALAJA TË JETË E VETË- QËNDRUESHME
4.2.1	Identifikimi dhe funksionalizimi i bizneseve shërbyese/ promovuese dhe hartimi i planit të biznesit
4.2.2	Përcaktimi i rregulloreve për shfrytëzim të hapësirave të kalasë
5.	MJEDIS, PLANIFIKIM HAPËSINOR, INFRASTRUKTURA DHE MENAXHIMI I RISKUT
5.1	TË TRAJTOHEN/ NDËRTOHEN RRUGËT PËR NË KALA
5.1.1	Plotësimi i infrastrukturës për shtegun e këmbësorëve (qasja nga Marashi)
5.1.2	Ndërtimi i rrugës nga Shkolla e Muzikës deri në Kala, me gjithë infrastrukturën nëntokësore
5.1.3	Investimet në rrugën ekzistuese, Sinan Pasha – Kalaja (rruga dhe infrastruktura – kanalizimi, ndriçimi dhe shenjëzimi)
5.1.4	Menaxhimi i infrastrukturës dhe ambientit në dhe përreth Kalasë (mbeturinat, ndriçimi brenda dhe jashtë)
5.1.5	Mirëmbajtja e rregullt e rrugëve dhe shtigjeve (Sinan Pasha – Kala, Shtegu i Marashit)
5.2	TË KETË SIGURI TË SHTUAR PËR MONUMENTIN DHE VIZITORËT

PLANI I MENAXHIMIT PËR KALANË E PRIZRENIT

5.2.1	Sigurimi i pronës për zhvendosjen e rezervuarit të ujit (studimi i fisibilitetit dhe projekti)
5.2.2	Hartimi i planit për emergjenca për Qendrën Historike të Prizrenit
5.2.3	Sigurimi i lokalitetit me kamera
5.2.4	Mirëmbajtja e vazhdueshme e ndriçimit
5.3	TË HARMONIZOHEN DOKUMENTET/ PLANET LIDHUR ME KALANË
5.3.1	Integrimi i Kalasë së Prizrenit në Planin e Konservimit të Qendrës Historike të Prizrenit
6.	KOMUNIKIM: INTERPRETIM, PREZANTIM DHE PROMOVIM
6.1	KALAJA E PRIZRENIT, TË JETË E QASSHME PËR TË GJITHË
6.1.1	Takime me personat me nevoja më të veçanta dhe institucione relevante, që të bëhet identifikimi i pengesave dhe të merren rekomandimet e tyre
6.1.2	Hulumtimi dhe aplikimi i praktikave të suksesshme të vendeve tjera për qasje gjithëpërfshirëse
6.1.3	Përmbajtja brenda kalasë të jetë e dizajnuar për personat me nevoja të veçanta
6.1.4	Interpretimi digjital (aplikacioni, web)
6.1.5	Funksionalizimi i info qendrave ekzistuese
6.1.6	Menaxhimi i audio guidave
6.1.7	Vendosja e paneleve (nga Shatërvani deri në Kala dhe brenda Kalasë) dhe vendosja e shtigjeve brenda kalasë
6.1.8	Promovimi i kalasë në pikat hyrëse të turistëve në Kosovë dhe në qytetet e mëdha turistike
6.1.9	Mbledhja e rrëfimeve nga qytetarët për kalanë
6.2	TË HARTOHEN UDHËZUES DHE BAZË LIGJORE PËR INTERPRETIM
6.2.1	Lobimi për përshpejtimin e miratimit të certifikimit të ciceronëve
6.2.2	Trajnimi/Menaxhimi i ciceronëve me orar të plotë (punë primare)
6.2.3	Krijimi i një grupi ekspertësh për unifikimin dhe verifikimin e teksteve/materialeve promovuese
6.3	KALAJA TË FUNKSIONOJË SI HAPËSIRË MULTIFUNKSIONALE
6.3.1	Organizimi i aktiviteteve kulturore
6.3.2	Organizimi i kampeve verore, me qëllim edukimi

8. NJËSIA MENAXHUESE

Nga të gjithë pjesëmarrësit në procesin e hartimit e planit të menaxhimit, është kërkuar themelimi i një njësie përgjegjëse, që do të merret me menaxhimin e të gjitha çështjeve që lidhen me Kalanë e Prizrenit.

Njesia menaxhuese per Kalanë e Prizrenit do të emërohet me vendim te Ministrit te MKRS-së me këtë përbërje: Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit – Departamenti i Trashegimise Kulturore, Institutit Arkeologjik i Kosovës dhe Komuna e Prizrenit.

Përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësiave për njësinë menaxhuese bëhet me vendim. Krahas njësisë menaxhuese do te emërohet edhe Komisioni i cili do të jetë përgjegjës për shqyrtimin dhe miratimin e aktiviteteve qe organizohen ne Kala të Prizrenit. Komisioni do të ketë këtë përbërje:

1. MKRS/DTK – nje perfaqesues
2. IAK – dy perfaqesues
3. IKMM – nje perfaqesues
4. MKK – nje perfaqesues
5. QRTK Prizren – nje perfaqesues
6. KK Prizren – nje perfaqesues
7. Shoqeria Civile – dy perfaqesues

Komisioni propozohet nga DTK në përbërje prej tetëmbëdhjetë (18) antarëve, për secilin përfaqësues nga dy propozime. Propozimet për emerim i shkojnë Ministrit për Kulturë, Rini dhe Sport. Ky komision ka mandati katër (4) vjeçarë. Në takimet e komisionit merr pjesë edhe Menaxheri i Kalasë së Prizrenit, nëse i kërkohet nga komisioni.

8.1. Organizimi dhe përgjegjësitë

Bazuar në Ligjin nr.02/L-88 Ligji për Trashëgimi Kulturor, Ligji nr.04/L-66 Për Qendrën Historike të Prizrenit, Ligji nr. 03/L-39 Për Zonat e Veçante të Mbrojtura dhe Rregulloren (MKRS) nr.06/2017 për caktimin e institucioneve publike të Trashëgimisë Kulturorë, vartëse të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit në cilësinë e institucionit kompetent, Institucionet përgjegjëse vartëse të MKRS-së dhe institucionet tjera të nivelit qendror dhe lokal obligohen të ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë në zbatim të këtij plani.

Menaxheri i lekokalitetit dhe stafit të Kalasë së Prizrenit, menaxhon sipas detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara nga MKRS, hartonë planin vjetorë të punës, raportonë në baza mujore dhe vjetore.

Projekti “Ruajtja e Kalasë së Prizrenit” (RKPz) financuar nga Ambasada e SHBA në Prishtinë, si udhërrëfyes dhe sigures i mbështetjes teknike dhe financiare gjatë procesit të përgatitjes së Planit të Menaxhimit, duhet të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm për zbatimin e tij hap pas hapi, duke siguruar lehtësim dhe disa burime financiare, sidomos gjatë vitit të parë të zbatimit të Planit të Menaxhimit. Në vazhdim, Projekti Ruajtja e Kalasë së Prizrenit do të vë në zbatim disa aktivitete dhe mikro-projekte, të cilat janë identifikuar si prioritet në këtë Plan Menaxhimi. Projekti RKPz gjithashtu do të ndihmojë në ngritjen e kapaciteteve lokale për Njësinë e Menaxhimit.

8.2. Buxheti

Implementimi i Planit të Menaxhimit të KPZ-së varet nga ajo se sa e suksesshme do të jetë struktura menaxhuese (Njësia Menaxhuese) në ngritjen e fondeve dhe masave nxitëse. Inputi financiar nga buxheti i shtetit është i domosdoshëm për të mbuluar kostot e implementimit të planit të menaxhimit.

Duke pasur parasysh burimet e kufizuara financiare në shërbim të implementimit të PM, është esenciale të përcaktohen edhe mekanizma financiare dhe ekonomike të tjera për gjenerim të burimeve. Disa mekanizma financiare si pagesat për hyrje, lejet, shpërblime, etj., do të përdoren nga Njësia Menaxhuese, për ngritjen e fondeve për implementimin e PM. Çdo kontribut, i vogël apo i madh, financiar apo teknik, është i dobishëm për zbatimin e PM.

PLANI I MENAXHIMIT PËR KALANË E PRIZRENIT

Së fundi, është me rëndësi të nënvizohet se përgatitja dhe implementimi i këtij PM, do të ketë nevojë edhe për kontribute financiare nga donatorët. Ngritja e fondeve nga donatorët ndërkombëtarë dhe kombëtarë do të jetë një aktivitet prioritar i vazhdueshëm për Njësinë e Menaxhimit.

REFERENCAT

- CHwB (2011) Conservation and Development Plan for the Historic Zone of Prizren. Kosovo: CHwB.
- European Commission/ Council of Europe (2009) Preliminary Technical Assesment of the Architectural and Archaeological Heritage in South East Europe. Prizren Fortress (Kalaja) Prizren.
- Forsyth, M. (2007) Understanding historic building conservation. Oxford: Blackwell.
- Virmiça, R. (1999) Kosova'da Osmanli Mimari Eserleri, Ankara.
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (2015) Databaza e Trashëgimisë Kulturore. Kalaja e Prizrenit. E qasshme: http://dtk.rks-gov.net/tkk_objekti.aspx?id=6229

FOTOGRAFITË

- Fotoja e Kalas se Prizrenit, e fotografuar nga fotografi i albanologut te famshem Johann Georg von Hahn (1811- 1869) e realizuar ne vitin 1963.
-

